

Biografi e shkurtër e z. Niko Hyka

Z. Niko Hyka ka përfunduar studimet universitare në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës në programin e studimit Master i Shkencave në Fizikë, gjatë periudhës 2002 – 2007 dhe është diplomuar me titullin 'Fizikan'. Në vitin 2016, ka përfunduar studimet e doktoratës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në fushën e Imazherisë Mjekësore dhe Radioterapisë dhe në vitin 2024 ka marrë titullin akademik “Profesor i Asociuar”, akorduar nga Universiteti i Tiranës. Prej vitit 2007, z. Hyka është angazhuar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe aktivitete të tjera në fushën e arsimit dhe shëndetësisë. Njëkohësisht ka ushtruar funksione të ndryshme në administratën publike, arsimin e lartë dhe sektorin privat.

Ai ka qenë pjesë e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin të lartë, fizikan mjekësor në Spitalin Universitar “Nënë Tereza”, personel akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe në disa institucione të tjera të arsimit të lartë.

Z. Niko Hyka ka dhënë kontribute të rëndësishme në sigurimin e cilësisë në arsim, ekspertiza shkencore në fushën e fizikës mjekësore, diagnostikës, radioterapisë dhe përdorimit të inteligjencës artificiale në mjekësi.

Prej vitit 2016 është Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Fizikës mjekësore, (AAMP) dhe anëtar i Shoqatës Evropiane të Fizikës Mjekësore (EFOMP).

Në vitin 2019, ka themeluar Institutin për Cilësi në Arsim (IQE) dhe në vitin 2020 është certifikuar si ekspert i pajisjeve mjekësore.

Në veprimtarinë e vet disavjeçare, z. Hyka ka marrë pjesë në projekte, konferenca shkencore, është hartues i disa dokumenteve strategjike e rregullatorë në arsim e shëndetësi, ka botime e publikime në fushën e fizikës mjekësore dhe diagnostikës, trajnime e certifikime, angazhime si recensues i revistës shkencore “*Physica Medica*”, “*European Journal of Medical Physics*”, anëtar i komitetit drejtues për Shqipërinë i Institutit Ndërkombëtar i Evropës Juglindore për Teknologjitë e Qëndrueshme (SEEIIST), drejtues i Grupit kërkimor “*AI applications in medical imaging research group*” në NanoAlb pranë Akademisë së Shkencave etj.

Z. Hyka ka lindur në Pogradec dhe banon në Tiranë. Ai është i martuar me dy fëmijë.